



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108, paragrafit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.15 të Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 25 i Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat, Ligji Nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë, Marrëveshja e Drejtësisë, të datës 9 shkurt 2015, dhe Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 5 dhjetor 2016, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet shtojca e Rregullorës për Organizimin e Brendëshëm të Gjykatave.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Nehat Idrizi,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës


Kopje e vendimit i dërgohet:

- Kryetarëve të gjykatave të Kosovës
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në bazë të nenit 108, paragrafit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 4 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.15 të Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 25 i Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat, Ligji Nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë, Marrëveshja e Drejtësisë, të datës 9 shkurt 2015, dhe Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave, në mbledhjen e 167-të, të mbajtur më 5 dhjetor 2016, miraton këtë:

SHTOJCË E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË GJYKATAVE

Neni 1 Fushëveprimi

1. Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Rregullores për organizimin e brendshëm të gjykatave (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).
2. Pa rënë ndesh me tekstin origjinal të Rregullores, kjo shtojcë përcakton rregullat për çështjet organizative, përbërjen e kolegjeve gjyqësore, shpërndarjen e lëndëve dhe aktiviteteve tjera që lidhen me Divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Divizioni), dhe ankesat që vijnë nga gjykatat e identifikuar në nenin 3 të kësaj shtojce, siç parashihet me Marrëveshjen e Drejtësisë.
3. Pavarësisht nga dispozitat e përcaktuara në këtë shtojcë, Rregullorja është e zbatueshme për Divizionin në tërësinë e saj.

Neni 2 Vendi

Divizioni do të vendoset në mënyrë të përhershme në aneksin e ndërtesës së Gjykatës Themelore në Mitrovicë (ish ndërtesa e Gjykatës së qarkut në Mitrovicë).

Neni 3

Komunat me shumicë të popullatës serbe

1. Për qëllime organizative të juridiksionit të lëndëve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës njeh komunat e shënuara më poshtë si "komunat e Kosovës me shumicë serbe", siç është e përcaktuar në pikën 10 të Marrëveshjes së parë. Këto komuna janë si në vijim:
 - 1.1 Komuna e Mitrovicës veriore;
 - 1.2 Komuna e Leposaviqit;
 - 1.3 Komuna e Zveçanit;
 - 1.4 Komuna e Zubin Potokut;
 - 1.5 Komuna e Graçanicës;
 - 1.6 Komuna e Klllokotit;
 - 1.7 Komuna e Ranillugut;
 - 1.8 Komuna e Shtërpçës;
 - 1.9 Komuna e Novobërdës;
 - 1.10 Komuna e Parteshit.
2. Në përputhje me nenin 10, paragrafin 9 të Ligjit për gjykatat, gjykatat apo degët e mëposhtme kanë juridiksion mbi komunat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni:
 - 2.1. Dega e Graçanicës për Komunën e Graçanicës;
 - 2.2. Gjykata Themelore e Gjilanit për komunat e Ranillugut, Klllokotit dhe Parteshit;
 - 2.3. Dega e Novobërdës për komunën e Novobërdës;
 - 2.4. Dega e Shtërpçës për komunën e Shtërpçës;
 - 2.5. Gjykata Themelore e Mitrovicës për komunën e Mitrovicës veriore dhe komunën e Zveçanit;
 - 2.6. Dega e Zubin Potokut për komunën e Zubin Potokut;
 - 2.7. Dega e Leposaviqit për komunën e Leposaviqit.
3. Pavarësisht nga se u tha më lartë, të gjitha lëndët tjera të shqyrtuara në Gjykatën Themelore në Prishtinë lidhur me lëndët ekonomike dhe administrative caktohen sipas rregullave të përcaktuara në Rregullore dhe shtojcën.

Neni 4

Juridiksioni i Divizionit

Ky Divizion, si pjesë e Gjykatës së Apelit, do të ketë juridiksion për të gjykuar të gjitha lëndët e shkallës së dytë që vijnë nga gjykatat e shkallës së parë të komunave të shënuara në nenin 3, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.1 deri 1.4 dhe paragrafin 3 lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafin 1.1 deri 1.4.

Neni 5
Organizimi i Divizionit

1. Divizioni përbëhet prej shtatë (7) gjyqtarëve, prej të cilëve pesë (5) gjyqtarë do të jenë nga komuniteti serb dhe dy (2) nga komuniteti shqiptar.
2. Divizioni udhëhiqet nga Udhëheqësi i divizionit, i përzgjedhur në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni.
3. Udhëheqësi i Divizionit zgjedhet si në vijim:
 - 3.1. Kryetari i Gjykatës së Apelit, pas konsultimit me gjyqtarët e Divizionit, propozon përzgjedhjen e një gjyqtari nga komuniteti serb për udhëheqës të Divizionit. Gjyqtarët e Divizionit mund të zhvillojnë konsultime të brendshme për propozimin për Udhëheqës të Divizionit dhe të propozojnë një kandidat për Udhëheqës të Divizionit tek Kryetari i Gjykatës së Apelit.
 - 3.2. Kolegjiumi i Gjykatës së Apelit, brenda afatit kohorë prej shtatë (7) ditësh nga paraqitja e propozimit të Kryetarit të Gjykatës së Apelit në Kolegjium, miraton apo refuzon emërimin e Udhëheqësit të Divizionit nga Kryetari i Gjykatës së Apelit.
 - 3.3. Nëse kolegjiumi refuzon kandidatin e kryetarit të gjykatës brenda afatit kohor të specifikuar në nën-paragrafin 3.2. të këtij neni, kryetari i gjykatës propozon një kandidat tjetër pas konsultimit siç parashihet në nën-paragrafin 3.1 të këtij neni.
 - 3.4. Nëse kolegjiumi refuzon kandidatin e propozuar nga kryetari i gjykatës në pajtim me nën-paragrafët 3.1. deri 3.3. të këtij neni, kryetari i Gjykatës së Apelit, pas konsultimeve me gjyqtarët e Divizionit, do të përzgjedhë një gjyqtar nga komuniteti serb që të jetë Udhëheqës i Divizionit.
 - 3.5. Nëse Kolegjiumi i Gjykatës së Apelit nuk vepron brenda afatit kohor të specifikuar në nën-paragrafin 3.2. të këtij neni për të miratuar ose refuzuar kandidatin e propozuar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit, kandidati i Kryetarit të Gjykatës së Apelit do të përzgjidhet Udhëheqës i Divizionit.
 - 3.6. Udhëheqësi i Divizionit emërohet me mandat 2 vjeçar me mundësi vazhdimi.
4. Udhëheqësi i Divizionit është përgjegjës për organizimin e përditshëm dhe koordinimin e punës së Divizionit. Udhëheqësi i Divizionit zbaton rregullat dhe udhëzimet e Kryetarit të Gjykatës së Apelit brenda Divizionit dhe dorëzon raporte tremujore për punën e Divizionit tek Kryetari i Gjykatës së Apelit. Raporti tremujor përfshinë aktivitetet dhe vlerësimin e nevojave të Divizionit. Udhëheqësi i Divizionit paraqet rekomandime tek Kryetari i Gjykatës së Apelit për të gjitha çështjet që i përkasin punës së Divizionit.
5. Gjykata e Apelit do të ketë zëvendës Administratorin, siç parashihet në nenin 8 të Rregullores. Zëvendës Administratori koordinon punën e Divizionit nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e

Udhëheqësit të Divizionit dhe Administratorit të Gjykatës së Apelit. Zyra e zëvendës Administratorit vendoset në Divizion.

Neni 6

Përbërja e kolegjeve të Divizionit

1. Divizioni përbëhet prej kolegjeve që do të gjykojnë lëndë penale, civile, administrative, ekonomike dhe lëndë të kundërvajtjeve.
2. Çdo kolegji përbëhet prej dy (2) gjyqtarëve serbë të Kosovës dhe një (1) gjyqtari shqiptar të Kosovës, përveç kur gjykon vetëm raste të palëve shqiptare. Në këtë rast, kolegji përbëhet prej dy (2) gjyqtarëve shqiptarë të Kosovës dhe një (1) gjyqtari serb të Kosovës.

Neni 7

Kolegji i Gjykatës së Apelit

1. Kryetari i Gjykatës së Apelit duhet të sigurojë themelimin e kolegjeve (me seli në Prishtinë) për të gjykuar të gjitha lëndët që vijnë nga gjykatat e shkallës së parë të Komunave të listuara në nenin 3, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.5 deri 1.10 dhe paragrafin 3 në lidhje me paragrafin 1, nën-paragrafin 1.5 deri 1.10.
2. Rregullat për përbërjen e kolegjeve të përcaktuara sipas nenit 6 të kësaj shtojce do të jenë të zbatueshme edhe për Kolegjet e Gjykatës së Apelit të themeluara sipas nenit 7, paragrafit 1.

Neni 8

Regjistrimi i lëndëve

Të gjitha lëndët e pranuar nga Gjykata e Apelit regjistrohen dhe iu jepet numër unik, siç është specifikuar në Rregullore.

Neni 9

Caktimi i lëndëve dhe gjyqtarëve

1. Kryetari i Gjykatës së Apelit i cakton lëndët në kolegjin përkatës në këtë mënyrë:
 - 1.1. Të gjitha lëndët e vendosura nga gjykatat e shënuara në nenin 3, paragrafin 2, nën-paragrafët 2.5 deri 2.7, caktohen në një kolegji në përputhje me nenin 6 pas regjistrimit të tyre në Gjykatën e Apelit, dhe dorëzohen brenda dyzet e tetë (48) orësh ose në kohë më të shkurtër në rastet e paraburgimit tek Divizioni për gjykim.

- 1.2. Të gjitha lëndët e vendosura nga gjykatat e shënuara në nenin 3, paragrafin 2, nënparagrafët 2.1. deri 2.4, caktohen në një kolegji në përputhje me nenin 7, pas regjistrimit të tyre në Gjykatën e Apelit, dhe pastaj dorëzohen në Kolegjin e Gjykatës së Apelit për gjykim.
2. Kryetari i Gjykatës së Apelit, varësisht nevojave për gjykimin e rastit, i cakton gjyqtarët nga Divizioni për të gjykuar rastet në Kolegji(-et) e Gjykatës së Apelit.

Neni 10
Orari i seancave

Kolegjet e Divizionit informojnë zëvendës Administratorin lidhur me të gjitha lëndët që do të dëgjohen brenda muajit kalendarik Zëvendës Administratori informon Udhëheqësin e Divizionit dhe Administratorin e gjykatës, ky i fundit siguron që oraret janë publikuar në ueb-faqen e gjykatës.

Neni 11
Dërgimi i lëndëve

Pasi që Kolegji i Divizionit vendos lëndën, e njëjta do të kthehet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, që do të jetë përgjegjëse për dërgimin e vendimit në gjykatën e shkallës së parë.

Neni 12
Shkresat

Pas regjistrimit sipas nenit 8, palët mund t'i dërgojnë shkresat në lokacionin e Divizionit për ato lëndë që bien nën kompetencën e tij, ku këto shkresa do të regjistrohen në përputhje me Rregulloren në fuqi.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo Shtojcë e Rregullores hyn në fuqi më 07.12.2016

Prishtinë, më _____

Nehat Idrizi
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

